

Në bazë të nenit 10 paragrafi (1) dhe nënparagrafi (6) të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 30-të mbajtur më 5.8.2022, në lidhje me Propozimin PA1 nr. 08-225, datë 3.8.2022, për ngritjen e procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv ndaj SHTR televizion IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, miratoi si në vijim:

## KONKLUZË

1. Këshilli i Agjencisë ka ngritur procedurë për marrje të lejes për transmetim televiziv ndaj SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 42/20 dhe 77/21).

2. Në përputhje me Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.05-3026/1 datë 1.8.2022 transmetuesi nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar me nr.2022-100-0176 datë 27.6.2022, përfshirë këtu dhe datën 30.7.2022 i cili ka qenë afati i fundit ligjor i paraparë për pagesën e dëmshpërblimit në shumën prej 103.321.00 (njëqind e tre mijë e treqind e njëzet e një) denarë.

3. Kopje e Konkluzionit u dorëzua tek:

\_Udhëheqësit e të gjithë sektorëve në Agjenci;

- Personit të emëruar nga Agjencia, për menaxhimin e lëndëve sipas procedurës administrative;
- Njësisë për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë;
- Sektorit për Mbështetje informative dhe punë të përgjithëshme — arkivi i Agjencisë.

**Nr.02-3032/3**  
**08.08.2022**  
**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuale**  
**Kryetar i Këshillit,**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**